



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Legjislatura e III-të

Nr. 10/08

Prishtinë, më 14.05.2008, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: Gani Koci, Haki Shatri, Kosara Nikolić, Armend Zemaj, Myrvete Pantina, Xhevdet Neziraj, Besa Gaxherri, Müfera Şinik, Safete Hadërgjonaj Shkumbin Demaliaj.

Anëtarët jo të pranishëm: Behxhet Pacolli, Hajdin Abazi.

I ftuar: z. Bedri Hamza, zv. Ministër i Ministrisë për Ekonomi dhe Financave.

Nga shërbimi i sekretarisë: Natasha Tisma-Prica, Arta Hajra, Vilson Ukaj, Dashurie Canolli.

Gjithashtu të pranishëm ishin: z. Agim Krasniqi - Drejtor i Buxhetit në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, Lulzim Ismajli nga MEF, Flora Brovina-Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, Gjylnaze Novobrdaliu, Minire Beqaj, Nexhat Sylja, Rejhane Zylfijaj nga MPMS, Ismail Gashigazetar nga gazeta ditore “Kosova Sot”, monitruar nga OSCE, KDI, NDI.

Kryesues: Gani Koci, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente;**

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Buxhetit të Konsoliduar për vitin 2007

I ftuar: Ministri për Ekonomi dhe Financa;

4. Të ndryshme.

Kryetari hapi mbledhjen, përshëndeti pjesëmarrësit dhe propozoi rendin e ditës. Kryetari pasi konstatoi se ftesës për mbledhje nuk i'u janë përgjigjur Ministri i Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe Kryetari Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale propozoi të bëhet rirenditja e pikave të rendit të ditës, pika e tretë të shqyrtohet para pikës së dytë.

Rendi i ditës u miratua si i tillë i propozuar nga kryetari.

2. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Buxhetit të Konsoliduar për vitin 2007

I ftuar: Ministri për Ekonomi dhe Financa

Kryetari konstatoi se raporti vjetor financiar për Buxhetin e viti 2007 për nga aspekti i afateve procedurale është paraqitur më vonesë, por kjo për shkak të rrethanave objektive tashmë të njohura, zgjedhjeve nacionale dhe lokale. Në vazhdim kërkoi zv. Ministri z. Hamza të jep sqarimet lidhur me raportin në fjalë.

Zv. Ministri për Ekonomi dhe Financa z. Bedri Hamza theksoi se MEF duke u bazuar në Ligjin Mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi 2003/2 ka përgatitur raportin brenda afatit të paraparë (31 Mars) dhe i është dërguar institucioneve relevante që obligon Ligji. Raporti është ndarë në tri kolona: kolona e parë paraqet aprovimin e buxhetit nga Kuvendi dhe nënshkrimin të tij nga PSSP-ja, kolona e dytë paraqet rishikimin e buxhetit dhe kolona e tretë gjendjen e krijuar të sistemit informativ financiar të Rep.së Kosovës, ku janë paraqitur kërkesat e organizatave buxhetore për të bërë transfere nga një pozicion në një pozicion tjetër në lartësi prej 20%. Më pas z. Hamza shpjegoi strukturën e të hyrave dhe shpenzimeve. Të hyrat për vitin 2007 duke mos përfshirë grantet nga donatorët dhe mjetet e privatizimit kanë qenë 902.998,000 €, në përqindje shprehet prej 132.2%, çka do të thotë se ka pasur një tejkalim prej 32.2% e të hyrave nga ato të planifikuara. Në përgjithësi të hyrat për vitin 2007 në raport me të planifikuara kanë treguar performancë të mirë. Sa i përket kategorive të strukturës së të hyrave: dominojnë të hyrat nga doganat me një shumë prej 531.59100 €(58.9%), pasojnë të hyrat që ka grumbulluar Administrata Tatimore prej 182,542,000 €(20.2%), të hyrat nga komunat 29,237,000 €, të hyrat vetanake nga komunat 25,724,000 €(2.8%) dhe të hyrat jotatimore qeveritare (nga gjobat, tarifet etj.) marrin pjesë me 6.5%. Më pas z. Hamza paraqiti strukturën e shpenzimeve: janë shpenzuar 661,208,000 € prijnë shpenzimet për paga 208,923,000 €(32%), shpenzimet për mallra dhe shërbime 127,180,000 €(19%), shpenzimet për shërbime komunale 17,893 €(3%), shpenzimet për subvencione dhe transfere 153,552,000 €(23%), shpenzimet kapitale 154,767,000 €(23%). Nga ky bilanc i të hyrave dhe shpenzimeve, më 31.12.2007 mjetet e pashpenzuara (suficit) kanë qenë 397,144,000, duke përjashtuar grantet, të hyrat nga privatizimi, të hyrat vetanake të bartura për komunat dhe të hyrat nga fondet tjera të mirëbesimit, i cili suficit është e bartur në vitin vijues.

Safete Hadërgjonaj theksoi se ky raport nuk ndryshon shumë nga raportet e kaluara. Pas analizimit të tij shihet se shpenzimi i buxhetit nuk është orientuar në drejtim të duhur. Është shqetësues fakti se shpenzimet kapitale nuk janë orientuara në investime kapitale, me të cilat do të përfitonin qytetarët dhe mjetet do të i'u kthehen atyre në formë të të mirave publike. Në raport shifet se 13 Organizata Buxhetore nuk kanë shpenzuar më pak se 50% të mjeteve të tyre në investime kapitale, e që tregon një menaxhim jo të mirë të mjeteve të alokuara buxhetore, kjo ndoshta edhe për shkak të mungesës së kapaciteteve njerëzore. Vërejtje bëri edhe rreth strukturës së shpenzimit të mjeteve të cilat janë bërë më së shumti për paga dhe shërbime, si shpenzime luksi. Suficiti është i lartë edhe pse në të janë përfshirë mjetet e privatizimit dhe kërkoi që këto mjete të destinohen në drejtim të duhur. Vlerësoi pozitive paraqitjen e

zotimeve nga qeveria e re në raport dhe shfaqti besimin se këto mjete dhe do të orientohen në drejtim të të mirave publike. Vërejtje bëri edhe rreth avancave të paarsyetuara, sidomos kritikoi disa Ministri të cilat mjetet kapitale as nuk i kanë shpenzuar por as nuk i kanë zotuar, për këtë pyeti se si ka vepruar qeveria e re lidhur me këto avance. Sa i përket strukturës së të hyrave pranoi se ka pasur një ngritje në të gjitha kategoritë, por megjithatë qeveria kaluar nuk ka dal me projekte konkrete për shpenzimin e këtyre mjeteve që do të duhej të orientoheshin në investime kapitale dhe profitabile në mënyrë që të arrihej bilanci i kërkuar buxhetor i shpenzimeve në raport më të hyrat. Kjo tregon se buxheti nuk është menaxhuar mirë. Znj. Hadërgjonaj kërkoi që tani e tutje buxheti i miratuar të shpenzohet me efikasitet dhe efijencë në drejtim të të mirave publike dhe në përmisimin e mirëqenies së jetës së qytetarëve.

Myrvete Pantina vlerësoi raportin si përmbledhës, por megjithatë bëri disa vërejtje. Kërkoi të ndryshohet raporti i strukturës së të hyrave dhe shpenzimeve. Vlerësoi të rëndësishëm ekzistimin e buxhetit më të madh, por në të njëjtën kohë kërkoi që të shfrytëzohen burimet në mënyrë më racionale që të kemi mjete më të shumta. Të dhënat e paraqitura në raport tregojnë se disa kategori të grumbullimit të të hyrave kanë pësuar rënie. Të hyrat e grumbulluara nga tatimi në fitim, tatimi nga interesi apo lojrat e fatit kanë pësuar rënie në krahasim me vitin e kaluar. Po ashtu të hyrat nga licencat, sidomos nga licencat e biznesit kanë pësuar rënie të mëdha në krahasim me vitin 2006. Ndërsa të hyrat nga licencat për shfrytëzimin e pyjeve dhe licencat për produkte medicinale nuk ka fare. Sa i përket strukturës së shpenzimeve, shpenzimet e larta të bëra për për paga, mallra dhe shërbime janë të pafavorshme për ekonominë e vendit. Lidhur me kategorinë shpenzimeve tjera, znj. Pantina kërkoi sqarime se çfarë shpenzime janë përfshirë në kuadër të tyre.

Armend Zemaj bëri vërejtje rreth avanceve të paarsyetuara dhe shpenzimeve të bartura (borxhet e Ministrive), përmendi si shembull Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, që kanë shuma të tilla të avanceve të paarsyetuara. Kërkoi nga përfaqësuesit e MEF të dijë se sa i'u kanë qasur këtyre këtij problemi lidhur me avancet kur dihet se egzistojnë procedura dhe afatet kohore për mbylljen e tyre. Vlerësoi rritjen e të hyrave, që vërehen edhe nga licencat e lojërave të fatit. Kërkoi që gjatë rishikimit buxhetit të bëhet ndarja e saktë e prioriteteve buxhetore.

Xhevdet Neziraj vlerësoi pozitive faktin e përgatitjes dhe realizimit të buxhetit, i cili është më i mirë se sa që ishte në fillim të punës së institucioneve, kjo edhe për faktin se Këshillin Ekonomik Fiskal tani përbëhet nga stafi vendor. Sa i përket menaxhimit të mjeteve buxhetore shqetësuese është fakti i shpenzimit të tyre të lartë për paga por duke ditur nivelin e papunësisë dhe pagat e ulëta, me këtë situatë do të përballet edhe qeveria e re sepse kjo kushtëzohet me përmisimin e gjendjes ekonomike. Gëzon fakti i rritjes së të hyrave. Z. Neziraj theksoi se pengesë në realizimin e mjeteve ka paraqitur edhe Ligji Mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësisive 2003/2. Prandaj kërkoi të rekomandohet që këto pengesa ligjore dhe keq menaxhimet të evitohen dhe të mos përsëriten më.

Besa Gaxherri vlerësoi raportin teknikisht të përgatitur mirë. Brengos fakti i shpenzimit të mjeteve prej 32% për paga. Po ashtu shqetësues paraqet fakti i suficitit të mjeteve, sidomos suficiti që ekziston në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Arsimit të cilat mjetet nuk i kanë shpenzuar as nuk i kanë zotuar, ndërsa dihet se sa janë nevojat në këto fusha. Kritikoi avancet e paarsyetuara, por sipas znj. Gaxherri më shqetësues është fakti i mjeteve prej 8 milion eurove të ndara për statusin e Kosovës, arsyetueshmëria e të cilave ende nuk është bërë. Përveç çështjes së raportit për buxhetin e viti 2007 që tashmë është çështje e mbyllur më shqetëson fakti së një rrjedh buxhetore po zbatohet edhe në vitin buxhetor 2008, Qeveria nuk ka projekte apo strategji konkrete për ndryshimin e strukturës së të hyrave dhe shpenzimeve. Megjithatë pres që pas rishikimit të buxhetit të fillohet me ndryshime në këtë drejtim.

Haki Shatri lidhur me strukturën e të hyrave shifet se ka pasur një ngritje në të gjitha kategoritë, duke kaluar parashikimet buxhetore. Në këto ndryshime nuk ka ndikuar vetëm licenca e operatorit të dytë të telefonisë mobile por edhe mobilizimi më i mirë i Administratës Tatimore dhe Shërbimit Doganor të

cilët kanë grumbulluar ë hyra më tepër se sa janë parashikuar. Kjo tregon se janë ngritur kapacitetet vendore. Por duhet vazhduar të punohet me komunitat që të shtohen të hyrat e tyre vetanake. Sa i përket strukturës së shpenzimeve asnjë kategori nuk ka tejkaluar parametrat buxhetor. Shpenzimet për mallra dhe shërbime janë më të vogla se sa që janë paraparë me buxhet, ndërsa shpenzimet për paga janë pothuajse të njëjta në krahasim me vitin paraprak. Dobësi paraqet fakti i shpenzimeve kapitale. Përgjegjësia për këtë do të duhej të bie ndaras për Organizatat Buxhetore. Në këtë drejtim është bërë përparim ku është mundësuar që projektet kapitale të papërfunduara të vazhdojnë edhe në vitin pasues. Rreth menaxhimit të mjeteve buxhetore duhet përfillur ligji i miratuar në Kuvend dhe MEF duhet vepruar konform këtyre procedurave. Nëse kemi pengesa atëherë të ndryshohet ligji, psh që të hyrat për TVSH të mos grumbullohen në kufij por brenda vendit. Sa i përket avanceve të pa mbyllura, kjo paraqet një problem në vete, disa mjete janë trashëguar në vitet e kaluara.

Müferra Şinik u shpreh pajtohet me shumicën e vërejtjeve. Buxheti për vitin 2007 është përgatitur mirë dhe do të analizojë më shumë dhe në mbledhjet e ardhshme nëse kërkohet do të jep propozimet e mija.

Kryetari në vazhdim paraqiti vërejtjet e tij lidhur me raportin: mungon një detajizimi i financimit të suficitit dhe deficitit, nuk është përfshirë numri i saktë i të punësuarve të institucioneve të reja qeveritare të krijuara gjatë viti 2007. Në raport nuk është përfshirë mënyra e shpenzimit të mjeteve të ndara për statusin e Kosovës. Sa i përket të hyrave nuk kemi rritje reale të të hyrave, por mosplanifikim të duhur të të tyre. Ndërsa lidhur me shpenzimet theksoi se shqetësuese është fakti i mosshpenzimit të mjeteve kapitale për 30% duke ditur se nga këto mjete do të përfitonin direkt qytetarët. Për një mosefikasitet të tillë Ligjet nuk kanë qenë pengesë, por ata që kanë qenë të obliguar ta realizojnë buxhetin. Shqetësues duhet të jetë fakti i mosrealizimit të projekteve kapitale brenda vitit të paraparë si për MEF, Qeverinë po ashtu edhe për Kuvendin. Sa i përket avanceve nuk është një shqetësim i madh. Përgjithësisht ky raport është i ngjashëm me atë të viteve të kaluara.

Safete Hadërgjonaj theksoi se kritikën rreth raportit financiar 2007 nuk i adresohen vetëm MEF, por edhe autoriteteve të pavarura. Lidhur me atë se a ka proceduar me dokumentacion Dep.Buxhetit rreth lëvizjes së mjeteve, kjo duhet të diskutohet kur të shqyrtohet raporti i Auditorit Gjeneral. Shqetësuese është mos realizimi i investimeve kapitale nga Agjen. e Pavarura të cilat kanë bërë kërkesat dhe i është lejuar ndërsa nuk kanë realizuar ato. Rast konkret është ART-ja.

Zv. Ministri për Ekonomi dhe Financa z. Bedri Hamza raporti është përgatitur konform Ligjit dhe standartve ndërkombëtare. Ne kemi përshkruar gjendjen si ka ndodhur. Edhe për ne është shqetësim rasti i shpenzimeve kapitale. Avancet e pambyllura i kemi paraqitur siç janë. Lidhur me zotimet të gjitha punët që kanë pasur kontrata kanë vazhduar për vitin 2008 ndërsa ato të cilat nuk kanë pasur kontrata i kemi bartur në suficitin e këtij viti. Ndërsa sa i përket zvogëlimit të të hyrave të disa pozicione ka pas rënie ndërsa të disa tjera ngritje, psh., tatimi paragykuar është ulur ndërsa të tatimi në fitim të korporatave të hyrat janë rritur. Sa i përket licencave ato janë paraqitur të hyra jo tatimore të nivelit qendror. Lidhur me shpenzimet për paga edhe pse është shuma më e madhe pagat realisht janë të vogla. Sa i përket suficitit kjo ka ndodhur për mjeteve të bartura prej vitit paraprak, për shkak të licencës së telefonisë, por edhe për shkak të sigurisë financiare që të kemi rezerva buxhetore, që ka qenë edhe rekomandim i FMN-së. Mjetet e statusit janë raportuar në MEF, nga fondi për negociata, të gjitha detalet egzistojnë dhe janë në dispozicione për të gjithë të interesuarit.

Haki Shatri kërkoi nga anëtarët që të jenë më racional gjatë komentimit të raportit. Duhet vlerësuar pozitivisht rritjen e të hyrave që janë më të mëdha se sa janë planifikuar. Sa i përket suficitit këto mjete janë si pasojë edhe atyre të trashëguara më herët. Avancet nuk paraqesin problem të madh, ndërsa mjetet e ndara për statusin janë detalet që mund të gjinden në MEF. Zgjerimi i kufijve buxhetor është arritur, kjo ka të bëjë me investimet kapitale, që do të ndihmonë në realizimin e këtyre projekteve që do të zgjatnin më tepër së një vit.

Besa Gaxherri kërkoi që në detale të raportohet për shpenzimin e mjeteve prej 8 milion eurove që janë ndarë për statusin, të raportohet edhe për ato që janë ndarë për vitin 2006.

Armend Zemaj lidhur me shpenzimet mjeteve për statusin është dashur që në këtë raport të kemi një pasqyrë rreth destinimit të tyre.

Safete Hadërgjonaj theksoi se është dashur që këto shpenzime të veçohen dhe të paraqiten në raport me kohë në mënyrë që mos ta diskutojmë më këtë çështje.

Pas vërejtjeve dhe sugjerimeve, më votimin e bërë Komisioni njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

Miratohet në parim Raporti financiar i Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitin 2007 dhe njëherazi i sugjerohet Kryesisë së Kuvendit të Kosovës që të njëjtin ta radhitë në rend dite për diskutim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente

Kryetari theksoi se komisioni me rastin e shqyrtimit të Projektligjit dhe amendamenteve ka pasur vërejtjet se dispozitat kanë implikime buxhetore. Vërejtjet kanë të bëjnë rreth krijimit të fondit për rehabilitim dhe punësim, a do të krijohet një llogari e veçantë, pastaj rreth amendamenteve që keni paraparë krijimin e nënkodeve, pagesa e asistentit të paaftësuarit i cili krijon mjete shtesë gjithashtu edhe gabimet gjuhësore që e bëjnë Projektligjin më abstrakt për tu zbatuar.

Flora Brovina theksoi qëllimi i amendamenteve ka qenë që personi të paaftë 100% t'i caktohet një përcjellës i cili do të merr një shumë të vogël. Nëse personi aftësohet atëherë hynë në punë dhe i kthen ato mjete. Qëllimi është që këta persona të socializohen dhe aftësohen dhe mjetet e pranuar të i kthejnë dhe të lirohet fondi nga ky obligim.

Armend Zemaj qëllimi ka qenë të krijohet një linjë e veçantë buxhetore e cila mundëson pagesën e këtyre personave, ndërsa nëse burimi nuk mund të quhet nënkod atëherë mund t'ia ndryshojmë emrin.

Haki Shatri vërejtjet kanë të bëjnë me nenet 26 dhe 27. Sa i përket nenit 26 është dashtë të saktësohet burimi i të hyrave ndërsa lidhur me nenin 27 të caktohet se mjetet duhet menaxhuar nga Ministria përkatëse, ndërsa mënyra e shpenzimit të rregullohet me akt nënligjor. Gjithashtu tha se nuk lejohen krijimi i fondeve të veçanta, mjetet menaxhohen sipas Ligjit Mbi Menaxhimin e Financave Publike.

Gjylnaze Novobrdaliu theksoi se amendamentet e kanë ndryshuar përmbajtjen e draftit dhe ato e kanë bërë projektligjin gjuhësisht më të pakuptueshëm.

Drejtor i Buxhetit në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave z.Agim Krasniqi theksoi se amendamentet e propozuar kanë implikime buxhetore dhe nuk janë në përputhje me deklaratën financiare. Gjithashtu këto shpenzime nuk janë në përputhje me Kornizën afat mesme 2009-2011 ku parashihet se nuk do të ketë rritje në skemën sociale. Krijimi i fondit do të ndikonte në ndryshimin e Ligjit Mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe ligjet tjera që kanë të bëjnë me tatimet. Dokumenti lenë shumë interpretime dhe nëse të aftësuarit nuk punësohen, kostoja është shumë e lartë deri në €17 milion

Haki Shatri nëse mund të bëhen zëvendësime nga Ministria përkatëse sa i përket kategorive është në rregull përndryshe mos të tejkalohen kufijtë e përcaktuar me Kornizë afat mesme.

Safete Hadërgjonaj theksoi problem paraqet kontributi prej 1% që është paraparë në nënkodin i cili nuk mund të krijohet sepse nuk e lejon Ligji. Po ashtu kërkoi që Ministrinë dhe komisionet përkatëse të koordinohen në mënyrë që Ligji i miratuar të jetë funksional dhe i zbatueshëm në aspektin financiar.

Kryetari theksoi amendamentin e paraqitur nga deputetja Teuta Sadri nuk mund të fusim në shqyrtim sepse nuk është paraqitur sipas procedurës së rregullt, po ashtu nuk ka përmbajtjen që duhet të ketë një amendament.

Pas vërejtjeve dhe sugjerimeve, më votimin e bërë Komisioni njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Dispozitat e Projektligjit për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe amendamentet e propozuara, përmbajnë implikime buxhetore, dhe si të tilla nuk janë në pajtim me politikën tatimore, Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe me kufijtë buxhetore të parashikuar në Kornizën afat mesme të shpenzimeve.
- II. Sipas kësaj, Komisioni për Buxhet dhe Financa i rekomandon komisionit përgjegjës referues (Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale) që të marrë parasysh vlerësimet e dhëna dhe në bashkëpunim me ministrinë sponzoruesi të projektligjit (Ministria Punës dhe Mirëqenies Sociale) dhe Ministrinë për Ekonomi dhe Financa të rishikojnë dispozitat e projektligjit dhe amendamentet të cilat përmbajnë implikime buxhetore, me qëllim të harmonizimit të qëndrimeve të tyre, dhe më pas të përcillen për shqyrtim në Komisionin për Buxhet dhe Financa.

4. Të ndryshme

Kryetari njoftoi anëtarët se ka pasur një takim me përfaqësuesit e NDI dhe ka marrë mbështetjen e tyre për të grumbulluar informacione rreth zbatimit të ligjit nga Organizatat Buxhetore. Ata do të përgatisin materiale që do të na shërbenin neve si informacion me rastin e vizitave që duhet bërë për të mbikëqyrur ligjet nga fusha e komisionit. Propozoi që të fillohet me mbikëqyrjen e dy ligjeve : ligjin për Auditimin e Brendshëm dhe Ligjin mbi Prokurorimin Publik.

Safete Hadërgjonaj u pajtua me propozimet e kryetarit për mbikëqyerjen e ligjeve pasi që edhe është pjesë e planit të punës së Komisionit. Këtë punë duhet bërë së bashku të gjithë anëtarët me një axhend të përgatitur. Pas mbikëqyerjes dhe marrjes së informacioneve të përgatitet raporti me rekomandime për në Kuvend.

Xhevdet Neziraj njoftoi se anëtarët në mandatin e kaluar në Komisionin për Ekonomi kanë bërë mbikëqyerjen e dy ligjeve, nga të cilat kanë vërejtur parregullsi dhe pas rekomandimeve të bëra kjo ka ndikuar edhe në Ministri që personave përgjegjës iu janë ndërruar pozicionet. Të mos shëndrohemi vetëm në instrument votimi por edhe në mbikëqyerjen e ligjeve se si po zbatohen ato.

Mbledhja përfundoi në ora 13:30

Shërbimi i komisioneve

Kryetari i Komisionit

Gani KOCI

